



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:112708
Datë: 08.07.2019
Numri i dokumentit: 00397915

C.nr.394/17

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses BKS, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar F. S., kundër të paditurit S.(N.)K., Komuna e Pejës, për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit: 147,00€, në shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.26.06.2019, në prani të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të paditurit, përpiluar me dt.04.07.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses BKS, me seli në Prishtinë, dhe DETYROHET i padituri S.(N.)K., Komuna e Pejës, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit, për aksidentin e dt.19.03.2013, t'i paguaj shumën në lartësi prej 147,00€, me kamat ligjore të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim në afat mbi një vit e pa destinim të përcaktuar duke filluar nga dt.04.07.2019, si ditë e vendim marrjes e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja nëpërmes të autorizuarit të saj, me padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pran padisë dhe kërkesës së saj, duke kërkuar që të detyrohet i paditur në rimbursimin e dëmit të shkaktuar, nga baza e auto përgjegjësisë për aksidentin e dt.19.03.2013, në arsyetim se me provat e administruara është vërtetuar në tërësi baza juridike dhe lartësia e kërkesë padisë, së paditëses, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar, shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për taksë gjyqësore në shumën prej 15€.

I padituri nuk ka dhënë përgjigje në padi edhe pse për një gjë të tillë ka qenë i ftuar në mënyre të rregullt nga ana e gjykatës, e po ashtu nuk ka prezantuar edhe në seancën e shqyrtimit kryesor edhe përkundër faktit se ftesën e ka pranuar në mënyre të rregullt. me çka gjykata konform dispozitës të nenit 423.4 të LPK-së, seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurit.

Gjykata në këtë çështje juridike-kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat dhe ate: dosjen e dëmit me nr.658/2013, në emër të dëmtuarit F. B. dhe atë; ujdin jashtëgjyqësore të dt.23.04.2013, të lidhur në mes të paditëses dhe të dëmtuarit; vendimin e paditëses të dt.15.04.2013, me të cilin është miratuar kërkesa e të dëmtuarit; vendimin e komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve të dt.15.04.2013; akt vlerësimin e dëmit; procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit; certifikatën e regjistrimit të automjetit; 3 fletë me nga 4 foto të

automjetit të dëmtuar; paraqitjen e dëmit; konfirmimin e sigurimit; L.Nj. e të dëmtuarit; policen e sigurimeve të të dëmtuarit; raportin e aksidentit të dt.09.03.2013, si dhe deklaratimet e të autorizuarit të palës paditëse.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të ligjit për procedurë kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike-civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara gjykata ka konstatuar se: me datën 19.03.2013, rreth orës 08:30 në Fushë Kosovë, ka ndodhur aksident i trafikut rrugor ku pjesëmarrës në këtë aksident ishte vetura e tipit VW Golf, me targa të regjistrimit ..., të cilën në momentin e aksidentit e drejtonte S.(N.)K. , Komuna e Pejës, i cili nga pakujdesia i shkakton dëme të dëmtuarit F. B.t. Automjeti i cili ishte shkaktar i këtij aksidenti në momentin e shkakimit të tij, ka qenë pa mbulesë sigurorese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimeve.

Nga ujdia jashtëgjyqësore me nr.FK-658/13 të dt.15.04.2013, gjykata konstaton se e dëmtuari në këtë aksident F. B., dhe BKS kanë lidhur marrëveshje për kompensimin e dëmit material, në shumën e tërësishëm prej 147,00€.

Nga Dokumenti Transferi me numër të xhirollogarisë ... në "T..." , të dt.16.05.2013, gjykata konstaton se Fondi i Garancisë së Kosovës, ka bërë pagesën e detyrimit sipas Ujdisë Jashtëgjyqësore të lartë cekur në llogari bankare të dëmtuarit në këtë aksident.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për rimbursimin e dëmit paditëses, gjenë mbështetje në dispozitat e Rregullës 3, për Ndryshimin e Rregullit për Sigurimet e Detyruara të Auto Përgjegjësive, nga Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar i Kosovës i dt.11.12.2007, e lidhur me dispozitat e nenit 245.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Paditësja është dashur ta kompensoj dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt. 19.03.2013, në bazë të dispozitës së nenit 4.6.1 të Rregullit 3, mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësive në të cilën shprehimisht parashihet së në rast të dëmit të shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit, ku pronari është dashur por nuk ka kontraktuar Sigurimin e Detyruar të Auto përgjegjësive-zhdëmtimi paguhet deri në të njëjtën shumë dhe sipas të njëjtave kushte sikur të ekzistonte Sigurimi i Detyrueshëm e Auto përgjegjësive nga Fondi i Garantues së Kosovës, në bazë të dispozitës së nenit 4.1, 2. pika a).

Meqenëse paditësja në bazë të provave prezent në shkresat të lëndës ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarit si pasojë e këtij aksidenti ka të drejtë që të kërkoj rimbursimin e shumës së paguaj në bazë të nenit 4.6 pika 2 të Rregullit 3, e cila shprehimisht parasheh së pas pagimit të dëmshpërblimit mund të bëhet rimbursimin i shumës së paguar në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit i cili nuk e ka siguruar automjetin, duke llogaritur këtu edhe kamatën me shpenzime.

Sipas dispozitës së nenit 7 të ligjit për procedurën kontestimore, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Meqenëse i padituri me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, andaj gjykata e vënë para një situatë të tillë dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik-civil, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit, në shumën prej 147,00€, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 245 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, i cili shprehimisht parasheh se kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij, dhe si rezultat i kësaj paditësjë ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i

padituri, me ç'rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësja e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 186 dhe 277 të LMD-së, për arsyeje se i padituri ka mësuar-ka ra në vonesë për detyrimin-rimbursimin e dëmit të shkaktuar nga data e vendosjes nga gjykata.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata i ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 15€, dhe atë për taksë gjyqësore.

Mbi bazën e të lartë shënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.394/17, me dt.04.07.2019.

G j y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLË JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtës, Gjykatës se Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.